



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr.256, datë 09.05.2024

**PËR
REFUZIMIN E KËRKESËS SË Z. {...}, PËR PËRJASHTIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT TË ZHVILLIMIT TË KARRIERËS NGA PROCEDURAT E
PËRZGJEDHJES PËR LËVIZJE PARALELE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË TIRANË PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME
VENDIMET NR. 256, 257 DHE 258, DATË 24.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.05.2024, pasi u njoh me kërkesën e gjyqtarit z. {...} për përjashtim të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Relacionin “Mbi kërkesën e z. {...}, për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nga procedurat e përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V Ë R E N

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka ardhur në rrugë elektronike¹, më datë 29.04.2024, kërkesa e z. {...} në të cilën kërkon përjashtimin e relatorit z. {...} dhe dy anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (KZHK), z. {...} dhe z. {...}, nga shqyrtimi i procedurave të përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për

¹ Në adresën elektronike të hapur nga anëtari z. {...} në funksion të përbushjes së detyrës së tij si relator i caktuar për procedurat e përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Në kërkesën e tij, z. {...} ka ngritur pretendime për njëanshmëri të relatorit dhe anëtarëve të KZHK duke qenë se kanë një marrëdhënie varësie të drejtëpërdrejtë “epror vartës” me kandidaten znj. {...} ({...}), e cila kandidon në të njëjtat procedura për lëvizjen paralele pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Kërkuesi z. {...} ka shpjeguar se referuar procesverbalit audio të mbledhjes plenare të datës 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, KZHK me relator z. {...}, ka propozuar kualifikimin e kandidates znj. {...} në procedurat konkrete të lëvizjes paralele.
4. Për shkak të rrethanave të mësipërme, si dhe marrëdhënies së varësisë mes anëtarëve të KZHK dhe kandidates znj. {...}, kërkuesi z. {...} ka ngritur pretendime për njëanshmëri me palët në procedurat administrative në shqyrtim.
5. Gjithashtu, për të shmangur konfliktin e interesit për anëtarët e këtij Komisioni, në referim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ai kërkon zëvendësimin e tyre me anëtarët zëvendësues, të cilët nuk kanë marrëdhënie varësie direkte me znj. {...}.
6. Kërkesën e tij për përjashtim të relatorit dhe anëtarëve të KZHK z. {...} e ka mbështetur në nenin 68, pika 3, neni 72 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 30 i Kodit të Procedurave Administrative, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik e profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

II. VLERËSIMI I KËSHILLIT

7. Së pari duhet theksuar se z. {...} i mungon qartësisht **mungesa e një interesi të ligjshëm** në kërkesën e dorëzuar për përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve të Komisionit, duke qenë se palët në një procedurë administrative janë përcaktuar qartë në Nenin 33 të Kodit të Procedurës Administrative. Vetëm subjekti i këtyre personave të përcaktuara në një procedim administrativ tërheqin të drejta dhe detyrime dhe përfshirja e tyre mbështetet tek cënimi i të drejtave dhe interesit të ligjshëm që mund të shkaktohet nga procedura administrative e iniciuar ndaj tyre. Në kushtet kur cënimi i interesit legjitim të personave që kanë statusin e palës në procedurën administrative përbën element të së drejtës së kërkimit (kupto ankimit administrativ), ky i fundit është thelbësor në krijimin e legjitimitetit aktiv dhe në investimin e organit administrativ. Edhe në procedurën administrative vlejné të njëjta rregulla për krijimin e legjitimitetit aktiv të ngjashëm si në atë të procedurës gjyqësore dhe i ngjashëm me interesin për të ngritur padi. Ky i fundit është një interes procedural, dytësor dhe instrumental në lidhje

me interesin material dhe ka për objekt vendimin që i kërkohet gjykatës të japë, si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material, i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi (ankim administrativ) lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur **interesin material** dhe për këtë arsye, në esencë, **presupozon njohjen e cenimit të një interesi** që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë, (kupto Organin Administrativ). (vendimi i Kolegjit Civil nr.264, datë 18.04.2013).

8. Për rastin në fjalë, vendimet e Këshillit respektivisht me nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 për hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë, si edhe vendimi nr. 161, datë 03.04.2024, për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim nuk çenojnë interesat ligjorë të z. {...}. Edhe vendimi nr. 230, datë 26.04.2024, mbi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk çënon interesat e z. {...} sipas argumenteve sa më sipër.
9. Së dyti kërkesa e depozituar nga z. {...} është dorëzuar **jashtë afateve logjore të parashikuara**. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ka përcaktuar rregulla të detajuara lidhur me kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rregullorja përmban parashikime mbi të drejtat e kandidatëve që në fillim të procesit të përzgjedhjes, ku përfshihen njoftimi mbi relatorin e caktuar, rastet dhe afati brenda të cilave mund të kërkhet përjashtimin i relatorit apo dhe të anëtarëve të tjerë të Këshillit.
10. Konkretisht, kandidati njoftohet për relatorin e procedurës së lëvizjes paralele menjëherë me caktimin e tij. Gjithashtu, në këtë Rregullore janë parashikuar dhe detyrime reciproke për secilën palë, ku nga ana e tij kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, jo më vonë së 3 ditë, nga marrja dijani e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.
11. Rezulton që vendimi i KLGJ-së për caktimin e relatorit z. {...}, për procedurën e përzgjedhjes i është njoftuar kandidatit z. {...} më datë 26.04.2024 duke i bërë me dije të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit brenda 3 ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Ky i fundit, me emailin e datës 29.04.2024 ka paraqitur kërkesë për përjashtim të relatorit dhe anëtarëve të KZHK-së.

12. Duhet shtuar se pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 256, 257, 258 datë 24.05.2023 gjendet e publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra, prej këtij momenti z. {...} ka patur dijeni mbi kandidimin e znj. {...} në këto procedura dhe nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim të anëtarëve të Komisionit, apo pretendime për gjendje të konfliktit të interesit.
13. Për më tepër, gjyqtari z. {...} përmes email datë 03.04.2024 është njoftuar nga ana e Këshillit në lidhje me caktimin e z. {...} si relator të procedurës së kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas vendimit të KLGJ me numër 161, datë 03.04.2024. Përmes email datë 08.04.2024, z. {...} është përgjigjur duke cituar marrjen në dijeni të caktimit të z. {...} si relator dhe mospasjen e asnjë kundërshtimi.
14. Edhe në këtë moment, z. {...} duke qenë në dijeni të shkaqeve (të pretenduara) të përjashtimit të një prej anëtarëve të KZHK, nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim. Sipas parashikimeve të vendimit nr. 320 të KLGJ, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kërkesa për përjashtimin e z. {...} do duhej të ishte paraqitur brenda 3 ditëve nga konstatimi i shkakut të përjashtimit pra të paktën. Çfarë në fakt nuk ka ndodhur duke qenë se z. {...} ka cituar shprehimisht se ka kundërshtime me relatorin e caktuar.
15. Sa më sipër rezulton se kërkesa e paraqitur nga z. {...} është jashtë afatit dhe nuk mund të shqyrtohet në themelin e saj. Megjithatë edhe sikur të ishte paraqitur në afat dhe të mund të shqyrtohej në themel, kërkesa e z. {...} për përjashtimin e relatorit dhe dy anëtarëve të KZHK, duke analizuar pretendimet e tij, legjislacionin në fuqi, e konkretisht ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, **gjendet e pabazuar në ligj dhe në prova**, në përputhje me argumentet vijuese.
16. Neni 75 i ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, parashikon si raste ku anëtari i KLGJ-së është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit, ndër të tjera edhe për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, në rastet e mëposhtme:
- a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën;
 - b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij;
 - c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet;
 - ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është

dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor;

d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit/bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor.

17. Lidhur me shkaqet e kërkesës për përjashtim, rezulton se vendimi i KLGJ nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” parashikon se shkaqet për përjashtim duhet të jenë bazuar në nenin 75 të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, asnjë prej shkaqeve që ai ka parashtruar nuk i referohet kësaj dispozite apo dhe shkaqeve/pengesave ligjore që parashikon Kodi i Procedurave Administrative për nëpunësit publik apo/dhe anëtarët e organeve kolegjiale.
18. Gjithashtu, në kërkesë z. {...} i referohet nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, dispozitë e cila ka parashikuar edhe rastet kur një nëpunës publik ose anëtar i organeve kolegjiale nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse.
- 18.1 Referuar kësaj dispozite z. {...} evidenton si një ndër rastet e këtij ndalimi/pengese ligjore është edhe ajo e parashikuar në shkronjën “g”, konkretisht citojmë : “g) nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim”.
- 18.2 Këshilli vlerëson se referimi në shkronjën “g” të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, për përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nuk qëndron për sa kohë nuk rezulton se relatori dhe anëtarët e tjerë të këtij Komisioni të kenë interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në këtë procedurë ku kandidon kërkuesi, prej nga ku mund të kenë arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim.
19. Duke marrë shkas nga kjo kërkesë, nuk konstatohet se anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës apo persona të lidhur me ta të kenë interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim të KLGJ-së.
20. Në vendimet nr. 256, 257, 258, datë 24.05.2023 me të cilat është hapur procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, parashikohen fazat e kësaj procedure. Konkretisht, në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit; në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar; në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.
21. Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar me vendim përfundimtar, në fazën e dytë të procedurës së lëvizjes paralele zbatohen rregullat sipas Kreut VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, përveç sa parashikohet ndryshe në “Dispozitat për periudhën kalimtare” sipas

Kreut VIII të tij.

22. Referuar pikës 91 të vendimit nr. 320 datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar njëkohësisht në vlerësimin krahasues të: a) rezultatit të vlerësimit etik dhe profesional përkatës; b) renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e gjyqtarit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Lidhur me renditjen e kandidatëve në procedurë, është një hap procedural i cili kryhet nga Shkolla e Magjistraturës. Pra, Komisioni në procedura të tilla dhe në rastin konkret, **nuk ka diskrecion vlerësues për të bërë renditjen e kandidatëve**, por mbështetet ekskluzivisht në materialet e Shkollës së Magjistraturës. Komisioni nuk mund të ndryshojë këtë kriter dhe as rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional përkatës.
23. Për më tepër, veprimtaria e këtij Komisioni dhe qëndrimi i anëtarëve të tij është thjesht në kuadër të një propozimi që i bëhet Këshillit ndërkohë ky i fundit, pasi vlerëson kërkesën, propozimin e bërë nga Komisioni, merr vendimin përkatës. Ky fakt u provua në rastin e propozimit të anëtarëve të KZHK, me relator sërish z. {...}, që kandidatja znj. {...} të transferohej në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shkak të suprimimit të pozicionit të saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Ky propozim është rrëzuar në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me vendimin nr. 42, datë 31.01.2024 znj. {...} është emëruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
24. Nga ana tjetër, neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” përkufizon “konfliktin e interesit” si: *“gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike”*. Më tej, në pikën 1 të nenit 5 të ligjit të sipërcituar, jepet kuptimi i nocionit “interesa privatë” e rezulton se asnjëri prej anëtarëve të Komisionit, nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të konfliktit të interesit pasi ata nuk rezultojnë të kenë asnjë interes privat, të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë në këtë procedurë vendimmarrëse.
25. Paanësia e Komisionit, nënkupton paanësinë e secilit prej anëtarëve të tij. Gjykata Kushtetuese është shprehur në jurisprudencën e saj² se: *“në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike dhe në një shtet të sunduar nga ligji. Paanshmëria e gjyqtarëve (nemo iudex in causa sua) kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe super partes (shih vendimin nr.23/2008 të Gjykatës*

² Vendimi i GJK me nr. 9, datë 23.03.2010.

Kushtetuese)”. Në rastin konkret, referuar të gjithë kuadrit ligjor dhe nënligjor për parandalimin e konfliktit të interesit, është garantuar paanshmëria e procedurës konkrete administrative.

26. Për më tepër z. {...} përmes kërkesës së tij ka kërkuar përjashtimin e relatorit dhe gjithë anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Duke ju referuar të njëjtës jurisprudencë nga Gjykata Kushtetuese, citohet se “... *Përjashtimi i gjyqtarëve do të çonte në mosarritjen e numrit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare (kuorumit) nga Gjykata dhe, për rrjedhojë, ajo do të bllokohej për të vazhduar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit për pastërtinë e figurës*”.

III. KONKLUSIONE

22. Për sa është argumentuar më sipër, rezulton se procedura e renditjes është zhvilluar në respektim të parimit të pavarësisë, meritokracisë, parimit të procesit të rregullt ligjor, si dhe të paanësisë. Në këto kushte, rezulton se nuk ka shkaqe ligjore për përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nga procedurat e përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 72, 75 dhe 76, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të KLGJ-së,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}, për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nga procedurat e përzgjedhjes për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} dhe anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR